

SHOQËRIA RAJONALE UJËSJELLËS KANALIZIME SARANDË SH.A

PROCESVERBAL - Tipi i kontratës - Shërbime

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

Objekti i procedurës: *Studim projektim:Ndertimi i rrjetit KUZ per fshatrat Metoq dhe Gjashte, Bashkia Sarande.*

Kodi përkatës në fjalorin e përbashkët të prokurimit (CPV):, 22114311-5 - Projekte

Vlera e fondit limit: 8,597,822 (tete milion e peseqind e nentedhjte e shtate mije e teteqind e njezet e dy) lek pa tvsh

Burimi i Financimit: Buxheti i Shtetit ,

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” (të ndryshuar), nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Sarandë Sh.A, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 10.*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”i ndryshuar.

Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetdeklarimit” dhe Neni 83 ”Sigurimi i ofertes”, te Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në mbështetje të nenit 30, pika 1, te VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik: citojmë Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me

përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82, i LPP “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetdëklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.

c. Vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri. (Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetdëklarimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 7, gërma “a” formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 10.*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, Operatori Ekonomik duhet të plotësojë kërkesat ligjore sipas pikës 1 të Shtojcës 9 të DST.

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10 të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit ose nëse do të jetë nevoja për t`u kërkuar sqarime nga AK.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2023, 2024, 2025 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 20% vlerës** së përlloragitur e kontratës që prokurohet.

2.2.2 Për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm Operatori ekonomik duhet të paraqesë kopje të çertifikuara të bilanceve të 3 (tre) viteve të fundit financiare (2023, 2024, 2025) të paraqitur në Autoritetet përkatëse Dega e Tatim Taksave të konfirmuara nga ky Autoritet si dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel të Autorizuar. Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse në dy balance të një pasnjëshme, nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Shëmin: Akt Ekspertiza e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, duhet të paraqitet nga OE vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma "c" të Ligjit nr.10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar.

a) Operatori Ekonomik duhet të paraqesë një vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2026, ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. Nr.9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", (i ndryshuar).

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga autoriteti përkatës në të cilin është regjistruar sipas QKB.

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10 të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit ose nëse do të jetë nevoja për t'u kërkuar sqarime nga AK.

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar sipas vlerës së fondit limit të kësaj procedure, sipas nenit 77, pika 3, të ligjit nr. 162/2020, si dhe neneve 43 dhe 47, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", me qëllim që autoriteti kontraktor të kuptojë nëse operatorët ekonomikë ofertues kanë apo zotërojnë mundësitë e nevojshme financiare për të përmbyllur punët publike me sukses. Xhirot e tre viteve të fundit janë 2022, 2023 dhe 2024, që rezultojnë të jenë përmbyllur edhe sipas legjislacionit tatimor. Përqindja e kërkuar mbi xhiron vjetore është një përqindje minimale sipas RRPP-ve dhe xhiro e tre vjetëve e kërkuar, jo vetëm që përputhet me praktikën administrative të prokurimeve publike të ndjekur deri më tani, por është e rëndësishme për të vlerësuar kapacitetin ekonomik të ofertuesit dhe kuptuar nëse është i aftë financiarisht për të përmbyllur punët publike pranë autoritetit kontraktor.

Po kështu, që nga operatorët ekonomikë të vërtetohet kapaciteti ekonomik, ata mund të paraqesin kopje të bilanceve të tre viteve të fundit për vitet 2022, 2023 dhe 2024, si mbas xhirove vjetore, të depozituara pranë autoriteteve përkatëse tatimore, të konfirmuara nga ky autoritet, sipas ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar", të ndryshuar. Paraqitja e bilanceve është një mundësi, në rast se operatori ekonomik ofertues paraqet xhirot e kërkuara. Këto kërkesa të vendosura në DST (për mundësinë e paraqitjes së bilanceve dhe detyrimin e paraqitjes së dokumenteve për xhiron vjetore) përputhen edhe me nenin 9 të ligjit nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" dhe ligjin nr. 10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe kontabilistit të miratuar", të ndryshuar, sipas të cilëve periudha e

raportimit financiar është 12 muaj dhe periudha e depozitimit të pasqyrave financiare është nga 12-15 muaj.

Gjithashtu, për të vërtetuar kapacitetin ekonomik, operatori ekonomik ofertues duhet të depozitojë vërtetim që konfirmon shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga pushteti lokal për tre vitet e fundit, në të gjitha njësitë e qeverisjes vendore ku ai ushtron aktivitetin sipas të dhënave përkatëse të ekstraktit të QKR-së/QKB-së. Kjo kërkesë buron nga neni 76 i LPP-së, ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, si dhe ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar, sipas të cilëve subjektet tregtare kanë detyrimin që të paguajnë taksat vendore, me qëllim që të ushtrojnë aktivitetin. Vitet përkojnë me 2022, 2023 dhe 2024. Të gjitha kërkesat lidhur me kapacitetin ekonomik janë të bazuara në legjislacionin e përmendur më sipër dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse ofertuesit kanë kapacitete për të nisur dhe përfunduar punët publike që prokurohen. Po kështu, duke qenë se mund

të marrin pjesë si ofertues edhe bashkime operatorësh ekonomikë, atëherë secili prej operatorëve ekonomikë të bashkuar, duhet të depozitojë dokumentacionin si më lart.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke i'u referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar, ku përcaktohen kushtet dhe afatet e dorëzimit për Deklaratat individuale vjetore e të ardhurave: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.”; si dhe shkronjës c, të nenit 41 të ligjit nr. 10091, datë 5.3.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, ku parashikohet se: “Detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese: ... c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm: i. totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii. shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii. ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël.”. Po kështu, kjo kërkesë bazohet edhe në udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 5, datë 30.01.2006 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Për të provuar përvojën e mëparshme në punët e realizuara, sipas nenit 41 të rregullave të prokurimit publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- Punë të ngjashme për realizimin e një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës në një vlerë jo më pak se 20% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet.

Për të vërtetuar këtë Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë Kontratën e shërbimit; vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës; fatura tatimore të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë Kontratë Shërbimi dhe fatura tatimore të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatoresh, operatori ekonomik ofertues, krahas dokumentacionit të sipërcituar për secilin rast respektivisht, duhet të paraqesë edhe kontratën e bashkimit të operatorëve shoqëruar me tabelën e ndarjes së punimeve, ku të cilësohen punimet, që ka marrë përsiper të kryejë secili anëtar i BOE.

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Argumentimi: *Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 41, pika 3, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar. Me anë të këtyre kritereve kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerat 40 % të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose në vlerën limit të kontratës për punët totale të ngjashme të kryera në 3 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar. Këto vlera janë vlerat minimale të kërkuara sipas RRPP-ve.*

a) *për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë Kontratën e shërbimit; vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës; fatura tatimore të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara, i shërbejnë autoritetit kontraktor për të kuptuar nëse ofertuesi ka qenë i angazhuar në veprimtari ndërtimore të ngjashme, i ka përmbyllur me sukses këto punë, si dhe ka kapacitet teknik për të përmbyllur punët që prokurohen nga autoriteti kontraktor.*

b) *për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë Kontratë Shërbimi dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjisllacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara, i shërbejnë autoritetit kontraktor për të kuptuar nëse ofertuesi ka qenë i angazhuar në veprimtari ndërtimore të ngjashme pranë subjekteve private, i ka përmbyllur me sukses këto punë, si dhe ka kapacitet teknik për të përmbyllur punët që prokurohen nga autoriteti kontraktor. Dokumentet e mësipërme janë të mbështetura edhe në legjisllacionin në fuqi të zbatueshëm për ndërtimet.*

Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatoresh, operatori ekonomik ofertues, krahas dokumentacionit të sipërcituar për secilin rast respektivisht, duhet të paraqesë edhe kontratën e

bashkimit të operatorëve shoqëruar me tabelën e ndarjes së punimeve, ku të cilësohen punimet, që ka marrë përsiper të kryejë secili anëtar i BOE. Kjo kërkesë bazohet në nenet 88 e në vijim të LPP.,

2.3.2 Liçensa profesionale, lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës:

Operatori ekonomik duhet të disponojë licencë projektimi sipas rregullores së miratuar me VKM nr. 943, datë 28/12/2016 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale për individë dhe persona juridikë në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrje e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”.

Licenca e projektimit duhet të ketë kategoritë si më poshtë:

3.a Objekte civile - industriale - turistike prej murature e skelet beton arme deri në 5 kate.

4.c Projektim të linjave e rrjeteve elektrike, për objekte civile e industriale.

4.f Projektim të sistemeve kundra zjarrit.

5.b Furnizim me ujë – kolektorë shkarkimi.

5.c Ujësjellës- kanalizime urbane – rurale.

5.f Vepra hidroteknike, galeri e tunele hidraulike, marrje uji, shkarkimi- shkarkues të ujërave të tepërta, vepra të marrjes së ujit nga rezervuarët, vepra të marrjes së ujit nga lumenjtë dhe marrja e ujit me puse.

6.b Rruge urbane kryesore dhe rruge interurbane kryesore.

8.a Rilevime inxhinierike.

Sqarim: Për licencat e lëshuara pas hyrjes në fuqi të Vendimit nr.943, datë 28.12.2016 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.759, datë 12.11.2014, të Këshillit të Ministrave ‘Për licencimin profesional të individëve dhe personave juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim” i ndryshuar me VKM. Nr. 943 date 28.12.2016. **Ofertuesit duhet të sjellin Liçencat e rinovuara në zbatim të këtij vendimi.** (Për Operatorët e huaj të bëhet njehsimi i liçencës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë institucionit përkatës, në plotësim të licencave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës).

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe *vendimin nr.759, datë 12.11.2014 të Këshillit të Ministrave, “Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjes e koaludimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, ndryshuar me VKM-në nr.943 datë 28.12.2016” (shënim-përcaktoni aktin ligjor ose nënligjor specifik dhe nenin përkatës, që parashikon licencimin e subjekteve, në lidhje me veprimtarinë përkatëse për realizimin e shërbimeve objekt kontrate).*

Sipas këtij kriteri, operatori/ët ekonomik duhet të dëshmojë se disponon liçensat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente.

Më konkretisht, po paraqesim argumentimet si më poshtë:

3.a – Objekte civile, industriale, turistike prej murature e skelet beton arme deri në 5 kate

Kjo kategori kërkohet pasi projekti përfshin projektimin arkitektonik dhe konstruktiv të objekteve civile/industriale/turistike me strukturë murature ose skelet beton arme deri në 5 kate. Projekti përfshin përcaktimin e skemës strukturore, elementeve mbajtëse, dimensionimin e tyre dhe verifikimet sipas normave teknike në fuqi.

4.c – Projektim të linjave e rrjeteve elektrike për objekte civile e industriale

Kjo kategori nevojitet për hartimin e instalimeve elektrike të objektit, duke përfshirë rrjetin e furnizimit me energji, panelet elektrike, ndriçimin e brendshëm dhe të jashtëm, sistemet e tokëzimit dhe masat e mbrojtjes elektrike sipas kërkesave teknike dhe standardeve të sigurisë.

4.f – Projektim të sistemeve kundër zjarrit

Kërkohet për projektimin e sistemeve të mbrojtjes nga zjarri, duke përfshirë rrjetin hidrant, sistemet e zbulimit dhe alarmimit, sinjalistikën e emergjencës, rrugët e evakuimit dhe masat e tjera të sigurisë kundër zjarrit në përputhje me legjislacionin dhe normativat përkatëse.

5.b – Furnizim me ujë – kolektorë shkarkimi

Kjo kategori justifikohet nga projektimi i rrjeteve të furnizimit me ujë dhe kolektorëve të shkarkimit që shërbejnë objektin ose zonën e zhvillimit. Përfshin dimensionimin hidraulik të tubacioneve, lidhjet me rrjetet ekzistuese dhe garantimin e funksionimit të sigurt të sistemit.

5.c – Ujësjellës – kanalizime urbane – rurale

Kërkohet pasi projekti përfshin projektimin e rrjeteve të ujësjellësit dhe kanalizimeve, duke siguruar furnizimin me ujë të pijshëm dhe largimin e ujërave të përdorura dhe atmosferike sipas standardeve teknike dhe mjedisore.

5.f – Vepra hidroteknike, galeri e tunele hidraulike, marrje uji, shkarkues etj.

Kjo kategori nevojitet në rast se projekti përfshin vepra të menaxhimit të burimeve ujore, si struktura të marrjes së ujit, shkarkues, rezervuarë, kanale, vepra drenazhimi ose elemente të tjera hidroteknike të lidhura me funksionimin e objektit apo infrastrukturës.

6.b – Rrugë urbane kryesore dhe rrugë interurbane kryesore

Kërkohet për projektimin e infrastrukturës rrugore që lidhet me objektin ose zonën e zhvillimit. Përfshin studimin e gjurmës, profilin gjatësor e tërthor, nyjet e lidhjes, sistemimin e trafikut, sinjalistikën dhe elementet e sigurisë rrugore.

8.a – Rilevime inxhinierike

Kjo kategori është e domosdoshme për kryerjen e rilevimeve topografike dhe inxhinierike të zonës së projektit. Të dhënat e përfituara shërbejnë si bazë për projektimin e objektit, infrastrukturës, rrjeteve teknike dhe verifikimin e kushteve ekzistuese në terren.

2.3.3. Operatori ekonomik duhet të ketë Drejtuesit Teknikë të Përfshirë në Licencën e Shoqërisë, si më poshtë, vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, diplomë, licensë profesionale individuale, CV, librezë pune dhe të listuar në listpagesat e Shoqërisë për periudhën e 3 (tre) muajve të fundit nga data e zhvillimit të procedurës:

1 (një) Drejtues Projekti Inxhinier Hidroteknik

1 (një) Projektues Inxhinier Ndërtimi

1 (një) Projektues Inxhinier Gjeodet

1 (një) Projektues Inxhinier Elektrik

1 (një) Projektues Inxhinier Mjedisi

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10 të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit ose nëse do të jetë nevoja për t'u kërkuar sqarime nga AK.

Stafi i angazhuar të paraqesë deklaratë disponueshmërie për kryerjen e shërbimeve që ka marrë përsipër të realizojë.

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Argumentimi: Operatori/ët ekonomik duhet të dëshmojë që ka stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin e suksesshëm të kontratës bazuar në neni 77, pika 4, të Ligjit 162/2020, “Për prokurim publik” dhe neni 41, pika 4, gërma b, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Njësia e prokurimit për vendosjen e stafit i është referuar Detyrës së Projektimit për këtë objekt pjesë e kësaj procedure, pjesë e secilave do të jenë të licensuar për shërbimet që priten të realizohen.

Më konkretisht, po paraqesim argumentimet për inxhinieret si më poshtë:

Për realizimin e këtij studim projektimi objekti nevojitet një ekip inxhinierësh të udhëhequr nga

1. Drejtues Projekti – Inxhinier Hidroteknik

Kërkohe për të koordinuar dhe administruar të gjitha disiplinat e projektimit, si dhe për të garantuar integrimin e zgjidhjeve teknike në përputhje me objektivat e projektit. Duke qenë se projekti përfshin elemente të furnizimit me ujë, kanalizimeve dhe veprave hidroteknike (kategoritë 5.b, 5.c dhe 5.f), drejtimi nga një inxhinier hidroteknik siguron hartimin dhe koordinimin e duhur të infrastrukturës hidraulike dhe lidhjen e saj me komponentët e tjerë të projektit.

2. Projektues – Inxhinier Ndërtimi

Kërkohe për projektimin e objekteve civile dhe veprave inxhinierike që përfshihen në projekt. Ai është përgjegjës për zgjidhjet konstruktive, dimensionimin e elementeve strukturorë dhe garantimin e qëndrueshmërisë dhe sigurisë së objekteve, në përputhje me kategorinë 3.a dhe me kërkesat teknike në fuqi.

3. Projektues – Inxhinier Gjeodet

Kërkohe për realizimin e rievimeve topografike dhe përgatitjen e bazës gjeodezike mbi të cilën do të mbështetet projektimi. Të dhënat topografike janë thelbësore për përcaktimin e gjendjes ekzistuese të terrenit, koordinatave, kuotave dhe elementeve të infrastrukturës ekzistuese, duke mbuluar kërkesat e kategorisë 8.a.

4. Projektues – Inxhinier Elektrik

Kërkohe për projektimin e rrjeteve dhe instalimeve elektrike të nevojshme për funksionimin e objektit dhe infrastrukturës së projektuar. Ai harton zgjidhjet për furnizimin me energji, ndriçimin, sistemet e komandimit dhe mbrojtjes elektrike, në përputhje me kategorinë 4.c.

5. Projektues – Inxhinier Mjedisi

Kërkohe për vlerësimin e ndikimeve mjedisore të projektit dhe integrimin e masave për mbrojtjen e mjedisit gjatë projektimit. Ai siguron që zgjidhjet teknike të jenë në përputhje me legjislacionin mjedisor, standardet e zhvillimit të qëndrueshëm dhe kërkesat për menaxhimin e ujërave, mbetjeve dhe mbrojtjen e ekosistemeve të zonës së projektit.

2.3.4 Operatori ekonomik, duhet të ketë Staf Ndhmës si më poshtë, vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, diplomë, licensë profesionale individuale, CV, librezë pune dhe të listuar në listpagesat e Shoqërisë për periudhën e 3 (tre) muajve të fundit nga data e zhvillimit të procedurës:

1 (një) Inxhinier Hidroteknik

1 (një) Inxhinier Gjeolog/Hidrogeolog/Shpimi për studimin Hidro-gjeologjik

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10 të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit ose nëse do të jetë nevoja për t'u kërkuar sqarime nga AK.

Stafi i angazhuar të paraqesë deklaratë disponueshmërie për kryerjen e shërbimeve që ka marrë përsipër të realizojë.

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Njësia e prokurimit për vendosjen e stafit i është referuar Detyrës së Projektimit për këtë objekt pjesë e kësaj procedure, pjesë e secilave do të jenë të licensuar për shërbimet që priten të realizohen.

Më konkretisht, po paraqesim argumentimet për inxhinieret si më poshtë:

Inxhinieri Hidroteknik kërkohet për realizimin e shërbimeve të lidhura kryesisht me llogaritjet hidraulike për dimensionimin e tubacioneve të rrjetit të furnizimit me ujë, bazuar në modelimin e sistemit si dhe llogaritjet hidraulike të tubacioneve të dergimit dhe shpërndarjes, pusetave të komandimit, pusetave të ajrimit, pusetave të kontrollit, analizën e sistemit alternativën e përzgjedhur për të gjithë zonën e studimit, sipas kushteve teknike të projektimit.

Kërkohet prania e një **Inxhinieri Gjeolog, Hidrogeolog ose Inxhinieri Shpimi** për realizimin e studimit hidrogeologjik, i cili përbën bazën teknike për vlerësimin e kushteve gjeologjike dhe hidrogeologjike të zonës së projektit. Ky specialist është përgjegjës për identifikimin dhe analizimin e formacioneve gjeologjike, karakteristikave të akuifereve, nivelit të ujërave nëntokësore, drejtimit të rrjedhjes së tyre dhe potencialit ujqor të zonës.

Gjithashtu, ai kryen interpretimin e të dhënave të marra nga sondazhet, shpimet dhe testet në terren, vlerëson ndikimin e projektit mbi burimet ujore nëntokësore dhe propozon masat teknike për mbrojtjen dhe shfrytëzimin e qëndrueshëm të tyre. Studimi hidrogeologjik është i domosdoshëm për

projektimin e veprave të furnizimit me ujë, puseve, sistemeve të drenazhimit, veprave të marrjes së ujit dhe infrastrukturës hidroteknike, si dhe për garantimin e sigurisë teknike dhe mjedisore të projektit.

Përfshirja e këtij specialisti siguron që projektimi të mbështetet në të dhëna të sakta mbi kushtet nëntokësore dhe burimet ujore, duke reduktuar rreziqet teknike gjatë zbatimit dhe funksionimit të veprës.

2.3.5 Një punësim mesatar i të paktën 7 (shtate) personave, për periudhën e 3 (tre) muajve të fundit nga data e zhvillimit të procedurës e vërtetuar me:

1. Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj;
2. Listpagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën e 3 (tre) muajve të fundit nga data e zhvillimit të procedurës shoqëruar me formularët e deklaramentit të pagesave për sigurimet shoqërore dhe shendetësore.

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10 të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit ose nëse do të jetë nevoja për t'u kërkuar sqarime nga AK.

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Përcaktimi i fuqisë punëtore minimale të kërkuar është bazuar në shpërbimet e kërkuara sipas Detyrës së Projektimit objekt prokurimi.

Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë, tregon besueshmëri për autoritetin. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë çdo dëshmi me këtë kohështrirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve dhe përvojën e tyre, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Gjithashtu duke ju referuar intensitetit të shërbimeve nevojitet operator ekonomik me staf të organizuar dhe të qëndrueshem për të garantuar shërbimet.

2.3.6 Operatori ekonomik duhet të jenë liçensuar nga Q.K.L. me kodin III.2.A për "Veprimtaritë e ekspertizës lidhur me Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis dhe Auditim Mjedisor"

2.3.7 Operatori ekonomik duhet të jetë i liçensuar nga Q.K.L. me kodin I.2.A për "Sherbime ekspertize ne fushen e mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpetimin"

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10 të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit ose nëse do të jetë nevoja për t'u kërkuar sqarime nga AK.

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Argumentimi: Ekspert mjedisor për hartimin e VNM është i nevojshëm për hartimin e raportit të Vlerësimi i Ndikimit ne Mjedis (VNM) sipas përcaktimeve të Detyrës së Projektimit.

Ky kriter është vendosur gjithashtu në përputhje me Ligjin Nr. 10 440, datë 7.7. 2011 "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis" të ndryshuar në pikën 18 të nenit 6 të të cilit është është parashikuar se:

"Ekspert i certifikuar i VNM-së" është personi fizik, i cili pajiset me certifikatën përkatëse nga ministria, për hartimin e raportit të VNM-së, ekspertizën mjedisore dhe auditimin mjedisor dhe pikën 3 të nenit 6 të këtij ligji është parashikuar se:

"Vlerësimi i ndikimit në mjedis (VNM)" është procesi që kryhet për vlerësimin e ndikimeve të rëndësishme, të drejtpërdrejta ose jo, në mjedis nga projekte të propozuara publike ose private nëpërmjet:

- a) përgatitjes së raportit të vlerësimit të ndikimit në mjedis nga zhvilluesi;*
- b) kryerjes së konsultimeve sipas kërkesave dhe procedurave të përcaktuara në kreun III të këtij ligji;*
- c) shqyrtimit nga autoriteti kompetent të raportit të vlerësimit të ndikimit në mjedis dhe të çdo informacioni tjetër shtesë nga zhvilluesi, kur është i nevojshëm, si dhe të çdo informacioni tjetër të rëndësishëm, marrë nëpërmjet procesit të konsultimeve;*
- ç) përfundimit të arritur, të arsyetuar nga autoriteti kompetent, për ndikimet e rëndësishme në mjedis të projektit, duke marrë në konsideratë rezultatet e shqyrtimit të raportit të vlerësimit të ndikimit në mjedis nga autoriteti kompetent dhe kur është e përshtatshme shqyrtimin e vet shtesë;*
- d) përfshirjes në vendimin e miratimit të zhvillimit të projektit nga autoriteti përgjegjës për miratimin e zhvillimit të përfundimeve të arritura të arsyetuara nga autoriteti kompetent."*

Kërkesa mbështetet në Ligjin nr.10440, datë 07.07.2011 "Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis", i ndryshuar.

Objekti i kontratës përfshin vepra infrastrukturore që janë subjekt i procedurave mjedisore.

Prania e specialistit të certifikuar siguron:

- identifikimin e ndikimeve mjedisore;
- respektimin e legjislacionit mjedisor;
- integrimin e masave mbrojtëse në projekt;
- përgatitjen e dokumentacionit të nevojshëm mjedisor.

Kërkesa që operatori ekonomik të jetë i pajisur me licencën e lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licencimit (QKL) me kodin **I.2.A – “Shërbime ekspertize në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”** është e nevojshme për të garantuar që projektimi dhe vlerësimi i masave të sigurisë kundër zjarrit të kryhen nga subjekte të autorizuar dhe me kompetencë profesionale në këtë fushë.

Kjo licencë siguron që operatori ekonomik disponon kapacitetet teknike dhe ekspertizën e nevojshme për hartimin, verifikimin dhe integrimin e sistemeve të mbrojtjes nga zjarri, duke përfshirë analizën e rrezikut nga zjarri, projektimin e sistemeve të alarmit dhe sinjalizimit, rrjeteve të hidranteve, sistemeve automatike të shuarjes së zjarrit, si dhe përcaktimin e rrugëve të evakuimit dhe masave të emergjencës.

Duke qenë se projekti përfshin objekte dhe infrastrukturë që duhet të respektojnë kërkesat ligjore dhe teknike për mbrojtjen nga zjarri, disponimi i kësaj licence garanton përputhshmërinë e dokumentacionit teknik me legjislacionin në fuqi, standardet kombëtare dhe ndërkombëtare të sigurisë, si dhe minimizimin e rrezikut për jetën, pronën dhe mjedisin.

Për rrjedhojë, kërkesa për licencën **I.2.A** është proporcionale me objektin e kontratës dhe e domosdoshme për sigurimin e cilësisë, sigurisë dhe ligjshmërisë së zgjidhjeve teknike që lidhen me mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin.

2.3.8 Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatat sipas Standarteve ISO, të vlefshme (ose ekuivalente), si me poshtë:

- a) Certifikatën e cilësisë së punimeve SSH/DIN/EN/UNI/ISO 9001-2015 e perditesuar (e vlefshme)/ose/ekuivalent. Certifikata të jetë leshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë
- b) Certifikatën për Sistemin e menaxhimit të mjedisit SSH/DIN/EN/UNI/ISO 14001- 2015 e perditesuar (e vlefshme). /ose/ ekuivalent. Certifikata te jetë leshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.
- c) Certifikatën SSH/DIN/EN/UNI/ISO 45001:2018 e përditësuar, (SSH/DIN/EN/UNI ISO 45001 – 2023) e vlefshme/ ose ekuivalent (Mbi Sistemet e menaxhimit të shendetit dhe sigurisë të

punëtorëve në punë ose ekuivalent). Certifikata të jetë lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Shënim: Në rastet e Bashkimit të Operatoreve ekonomik çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë certifikatën e mësipërme në bazë të zërave të marrë përsipër të realizojë sipas marrëveshjes së bashkëpunimit.

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është bazuar në nenin 79, “Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor” të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”. Për vet natyrën e veçantë, vendndodhjes dhe përmasat e objektit të kontratës që do të prokurohet, është tepër e rëndësishme që operatorët të kryejnë punimet dhe realizojnë objektin e kontratës me standardet e kërkuara të cilësisë. Sistemi i menaxhimit të cilësisë, është standardt që çdo subjekt juridik apo privat e ka qëllim në arritjen e suksesit. Kjo certifikatë lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës për sa kohë do të pranohen edhe ekuivalentet e tyre dhe i shërbejnë autoritetit pergjegjes për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre përpëmbushjen e plotë të kontratës. Certifikata ISO përshkruajnë tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar të këtij shërbimi dhe që i vlerëson këtë shërbim si të pranueshem për funksionin e kërkuar, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. *Çertifikatat e cilësisë janë në përputhje me natyrën dhe objektin e kontratës që prokurohet.*

ISO 9001:2015

Kërkohet për të garantuar ekzistencën e një sistemi të menaxhimit të cilësisë në proceset e projektimit, kontrollit dhe dorëzimit të dokumentacionit teknik.

ISO 14001:2015

Kërkohet për të garantuar menaxhimin e ndikimeve mjedisore të aktivitetit të operatorit ekonomik dhe përputhshmërinë me standardet ndërkombëtare të mbrojtjes së mjedisit.

ISO 45001:2018

Kërkohet për të garantuar menaxhimin e shëndetit dhe sigurisë në punë për personelin e angazhuar në rievime, inspektime dhe aktivitete në terren.

Këto certifikime janë në përputhje me nenin 79 të Ligjit nr.162/2020 dhe nenet 44-45 të VKM nr.285/2021, të cilat lejojnë kërkimin e standardeve të sigurimit të cilësisë dhe menaxhimit mjedisor.

2.3.9 Ofertuesi duhet të ketë në pronësi ose me qera Pajisjet Gjeodezike si më poshtë:

1 (një) Pajisje GPS

Në lidhje sa më sipër operatori ekonomik duhet të paraqesë: Faturë shitblerje ose kontratë qeraje të noterizuar (shoqëruar me dokumentat e pronsisë së qiradhënësit origjinal ose fotokopje e noterizuar) si dhe skedën teknike.

1(një) Pajisje Dron

Në lidhje sa më sipër operatori ekonomik duhet të paraqesë: Faturë shitblerje ose kontratë qeraje të noterizuar (shoqëruar me dokumentat e pronsisë së qiradhënësit origjinal ose fotokopje e noterizuar) si dhe skedën teknike.

1 Automjet 4x4

Për automjetin duhet paraqitur çertifikata e pronësisë (ne emer te subjektit), leja e qarkullimit, siguracioni dhe çertifikata e kontrollit teknik sipas legjislacionit ne fuqi. Për automjetet me qira krahas dokumentacionit të mësipërm të paraqitet edhe kontrata noteriale e qirasë ku perfshihet periudha e sherbimit.

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10 të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit ose nëse do të jetë nevoja për t`u kërkuar sqarime nga AK.

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Pajisje GPS sebashku me Pajisje Total Station kerkohen per te kryer matjet topografike dhe rilevimet qe lidhen me pozicionimin e rrjetit te ujësjellës - kanalizimeve kuotave gjeodezike, kordinative te rrugës dhe të gjithë hapësirës ku mendohet të kalojë sistemi i furnizimit me ujë, pusetave te kontrollit , pusetave te ajrimit, pusetave te shkarkimit , depove rregulluese, plani i piketimit dhe verifikimi paraprak në terren për saktësinë e të dhënave përpara fillimit të projektit të zbatimit.

Kërkohet për shkak të natyrës së projektit dhe nevojës për akses në zona rurale, kodrinore ose me terren të vështirë ku do të realizohen inspektimet dhe matjet në terren.

Disponimi i automjetit garanton kryerjen e aktiviteteve të terrenit në kohë dhe sipas kërkesave të kontratës.

Përfundimisht, të gjitha kërkesat e mësipërme janë në përputhje me nenin 77 të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, nenin 41 të VKM nr.285/2021 dhe legjislacionin sektorial në fuqi, janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës dhe janë proporcionale me natyrën, kompleksitetin dhe vlerën e saj.

Argumentim për Pajisjen GPS

Kërkesa për disponimin e të paktën **1 (një) pajisjeje GPS** është e nevojshme për realizimin me saktësi të aktiviteteve të rilevimit topografik, përcaktimit të koordinatave, lokalizimit të pikave në terren dhe referencimit gjeohapësinor të elementeve që lidhen me projektin. Pajisja GPS mundëson mbledhjen e të dhënave të sakta gjeodezike, të domosdoshme për hartimin e planeve topografike, studimeve hidrogeologjike, projektimit të rrjeteve inxhinierike dhe verifikimin e kushteve ekzistuese në terren.

Paraqitja e faturës së blerjes ose kontratës së qirasë së noterizuar, së bashku me dokumentacionin e pronësisë dhe skedën teknike, kërkohet për të provuar disponueshmërinë reale të pajisjes dhe karakteristikat e saj teknike gjatë periudhës së realizimit të kontratës.

Argumentim për Pajisjen Dron

Kërkesa për disponimin e të paktën **1 (një) droni** është e justifikuar nga nevoja për kryerjen e inspektimeve ajrore, fotogrametrisë, ortofotove dhe dokumentimit të gjendjes ekzistuese të zonës së projektit. Përdorimi i dronit mundëson mbledhjen e të dhënave të detajuara në sipërfaqe të gjera ose në zona me akses të kufizuar, duke rritur saktësinë dhe efikasitetin e studimeve topografike, hidrologjike dhe mjedisore.

Paraqitja e faturës së blerjes ose kontratës së qirasë së noterizuar, së bashku me dokumentacionin e pronësisë dhe skedën teknike, garanton se operatori ekonomik disponon mjetin e nevojshëm dhe se pajisja përmbush parametrat teknikë të kërkuar për realizimin e shërbimit.

Argumentim për Automjetin 4x4

Kërkesa për disponimin e të paktën **1 (një) automjeti tip 4x4** është e nevojshme për të garantuar lëvizjen dhe aksesin e stafit teknik në terrene të vështira, zona rurale, malore ose me infrastrukturë të kufizuar rrugore, ku do të kryhen matjet, rilevimet, inspektimet në terren dhe studimet teknike.

Duke qenë se studimet topografike, hidrogeologjike, mjedisore dhe inxhinierike kërkojnë prezencë fizike në terren dhe transport të pajisjeve teknike, automjeti 4x4 siguron realizimin e shërbimeve në kohë dhe në mënyrë të sigurt, pavarësisht kushteve të terrenit.

Kërkesa për paraqitjen e certifikatës së pronësisë, lejes së qarkullimit, siguracionit dhe certifikatës së kontrollit teknik, ose në rast qiraje kontratën noteriale përkatëse, synon të vërtetojë disponueshmërinë ligjore dhe funksionale të mjetit gjatë gjithë periudhës së zbatimit të kontratës, duke garantuar kapacitetin operacional të operatorit ekonomik për realizimin e objektit të prokurimit.

Operatori ekonomik ofertues në përlogaritjen e ofertës duhet ti referohet njoftimit të bërë me Nr. 5585 Prot. datë 25.07.2017 të Agjensisë së Prokurimit Publik "Rekomandim mbi mënyrën e përcaktimit të tarifave minimale të specifikuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.354 datë 11.05.2016 "Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim".

Mospërgatitja e ofertës sipas bazës ligjore të sipërpërmendur përbën shkak për skualifikim pasi ajo duhet të jetë brenda kufijve të vlerës minimale dhe maksimale të lejuar në kuptim të nenit 7/1 të VKM nr 354, datë 11.05.2016 "Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikimin të territorit, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim" i azhornuar.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për shërbimet objekt prokurimi, që do të përfshihen në termat e referencës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët "ose ekuivalenti i tij/saj".